



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)**, në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058, Ligji Nr. 04/L-122, si dhe Ligjit Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike, nën paragrafit 2 të paragrafit 2 të nenit 64 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me datën 21.06.2024, miraton këtë:

## **RREGULLORE NR. 06/2024 PËR MENAXHIMIN DHE MBIKËQYRJEN FINANCIARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE**

### **Neni 1** **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurat për financimin, menaxhimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të hyrave të subjekteve politike, si dhe përcakton kufijtë minimal dhe maksimal të gjobave dhe masave tjera.

### **Neni 2** **Menaxhimi i burimeve financiare dhe materiale**

1. Burimet financiare dhe materiale të subjekteve politike janë të përcaktuara sipas neneve 4, 5, 6 dhe 7 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP).
2. Subjektet politike obligohen që brenda tridhjetë (30) ditësh pas regjistrimit nga KQZ, të hapin llogarinë bankare dhe të regjistrohen në institucionin përkatës për tu pajisur me numrin fiskal.
  - 2.1. Për hapjen e llogarisë bankare, subjekti politik i regjistruar, duhet të dorëzoj vendimin e KQZ për regjistrim, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
  - 2.2. për tu pajisur me numrin fiskal si tatimpagues dhe që përdoret vetëm për qëllime tatimore, subjekti politik, duhet ta dorëzoj vendimin e KQZ për regjistrim, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

3. Subjekti politik, obligohet që ta dorëzojë në Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) konfirmimin për numrin e llogarisë bankare dhe numrin fiskal.
4. Nëse subjekti politik nuk i dorëzon në Zyrë, dëshmitë sikurse në paragrafin 3 të këtij neni, Zyra i rekomandon KQZ, që ta pezulloj subjektin politik.
5. Subjekti politik, obligohet që brenda afatit shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, i dhënë në vendimin për pezullim, t'ia dorëzoj Zyrës, dëshmitë sipas paragrafit 3 të këtij neni.
6. Nëse subjekti politik nuk i dorëzon dëshmitë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, i dhënë në vendimin për pezullim, sipas rekomandimit të Zyrës, KQZ merr vendim për çregjistrimin e subjektit politik.
7. Subjektet politike duhet të kenë vetëm një llogari bankare, në njërin nga bankat komerciale të regjistruara në Republikën e Kosovës, përmes së cilës kryejnë të gjitha transaksionet.
8. Përjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij neni, subjekteve politike ju lejohet të hapin nën llogari bankare në kuadër të llogarisë kryesore, e cila do të shfrytëzohet vetëm për:
  - 8.1. transferim të mjeteve nga llogaria kryesore;
  - 8.2. tërheqjen e buxhetit mujor nga degët e subjektit politik.
9. Nën llogaria bankare nuk mund të shfrytëzohet për pranim të donacioneve.
10. Kryetari i degës i subjektit politik apo personi i autorizuar të degës, obligohet ta ketë autorizimin e nënshkruar nga kryetari i subjektit politik, për tërheqjen e mjeteve buxhetore nga nën llogaria bankare.
11. Subjekti politik, obligohet që t'ia paraqes Zyrës, të dhënat bankare, si: emrin e bankës komerciale të regjistruar në Republikën e Kosovës, numrin e xhirollogarisë bankare dhe të dhënat e të gjitha nën llogarive bankare, nëse kanë nën llogari bankare.
12. Zyra kërkon nga Banka Qendrore e Kosovës, konfirmimin se subjektet politike kanë vetëm një llogari bankare.
13. Personat fizik ose juridik, mund të japin donacion në para të gatshme, nën pesëdhjetë (50) euro.
14. Subjektet politike, nuk mund të pranojnë donacion në para të gatshme, në vlerën mbi 49.99 euro.

15. Në rastet kur bëhet pranimi i donacioneve si në paragrafin 14 të këtij neni, përfaqësuesi financiar i subjektit politik, obligohet që më së largu pesë (5) ditë nga dita e pranimi, t'i derdh në llogarinë bankare.

### **Neni 3**

#### **Ndarja e mjeteve financiare nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike**

1. Financimi i subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës bëhet nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike (fondi) siç është përcaktuar në nenin 7 të LFSP.
2. Zyra sigurohet që për çdo vit, të bëjë një vlerësim paraprak për planifikimin e shumës së mjeteve financiare nga fondin, përmes kornizës afatmesme të shpenzimeve.
3. Zyra i rekomandon KQZ, ndarjen e mjeteve financiare nga fondin, për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
4. Për çdo vit, nga data pesë (5) janar deri me datën pesëmbëdhjetë (15) janar, KQZ merr vendim për ndarjen e mjeteve nga fondin.
5. Mjetet nga fondin, derdhen në llogaritë e vetme bankare të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, për çdo tre (3) muaj.
6. Për identifikimin e saktë të deputetëve të secilit subjekt politik që është pjesë e koalicionit, bashkangjitur me dokumentacionin për aplikim për certifikim të koalicionit, lista e kandidatëve të dorëzuar, duhet të përmbajë përkatësinë partiake për secilin kandidatë të partisë politike që është pjesë e koalicionit.
7. Në rast të humbjes së mandatit të deputetit dhe në listën e subjektit politik nuk ka kandidat të radhës, atëherë subjektit politik të radhës që fiton ulësen në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i ndahet fondin në proporcion me numrin e ulëseve.
8. Pas certifikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ, Zyra e njofton iniciativën për procedurën e regjistrimit të partisë politike dhe për pasojat e mos veprimit të regjistrimit si parti politike.
9. Në rast se iniciativa qytetare nuk regjistrohet si parti politike brenda periudhës së përcaktuar sipas Rregulloren Nr. 01/ 2024 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike, humb të drejtën e përfitimit nga fondin, për periudhën paraprake.

## Neni 4

### Qëllimi i përdorimit të mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike

1. Mjetet nga fondi, mund të përdoren për çfarëdo shpenzimi që ndërlidhet me aktivitetet si në vijim:

1.1. Financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike, që përfshinë:

1.1.1. takimet, ose forumet e organeve më të larta ekzekutive;

1.1.2. hulumtimet që kontribuojnë në hartimin e politikeve të subjekteve, duke përfshirë hulumtimet e opinionit publik.

1.2. Financimin e degëve të subjekteve politike, që përfshinë:

1.2.1. takimet ose forumet e degëve;

1.2.2. pagesat për qiranë e zyrës;

1.2.3. furnizime për zyrën;

1.2.4. shpenzimet për telefoni dhe internet;

1.2.5. shpenzimet e shërbimeve komunale;

1.2.6. mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirës;

1.2.7. organizimi i punëtorive;

1.2.8. ekskursione dhe aktivitete kulturore, rekreative/ sportive.

1.3. Financimin e takimeve dhe aktiviteteve të njëjësive përkatëse të organizimit të grave dhe të rinjve:

1.3.1. që kanë për qëllim promovimin e grave dhe të rinjve të subjekteve politike;

1.3.2. organizimi i punëtorive;

1.3.3. ekskursione dhe aktivitete kulturore, rekreative/ sportive.

1.4. Financimin e aktiviteteve të grupeve parlamentare që përfshinë:

1.4.1. shpenzimet e grupeve parlamentare, ose/ dhe deputetit individual me qëllim të përmbushjes së funksionit.

1.5. Për qëllime të mbështetjes së aktiviteteve të subjekteve politike, shpenzimet administrative/ operacionale, përfshijnë vet shpenzimet si në vijim:

1.5.1. blerjen e inventarit dhe pajisjeve të teknologjisë informative;

1.5.2. blerjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve;

- 1.5.3. shpenzimet e transportit;
  - 1.5.4. investimet kapitale dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre;
  - 1.5.5. pagesat e qirave, përfshirë obligimet tatimore për qira;
  - 1.5.6. pagat, kompensimet, mëditjet, tatimet dhe kontributet;
  - 1.5.7. shpenzimet e udhëtimit për nevoja të subjektit politik;
  - 1.5.8. furnizimet për zyrat;
  - 1.5.9. shpenzimet për telefoni dhe internet;
  - 1.5.10. shpenzimet për shërbimet komunale;
  - 1.5.11. mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrave;
  - 1.5.12. pagesat e kuotës së anëtarësisë në organizata politike ndërkombëtare;
  - 1.5.13. shpenzimet bankare, taksat gjyqësore dhe shërbime të përmbaruesit;
  - 1.5.14. shpenzimet e përfaqësimit.
- 1.6. Për të gjitha shpenzimet dhe aktivitetet të parapara në këtë nen, subjekti politik obligohet të bashkëngjisë procesverbalin dhe raportin e aktivitetit të miratuar nga organi i paraparë sipas statutit të subjektit politik.
- 1.7. Për blerjet në vlerën 1,000 euro deri në 10,000 euro, subjektet politike obligohen që të ndjekin procedurën e kontraktimit të operatorit me së paku tri (3) oferta nga operator të ndryshëm ekonomik.
- 1.8. Për blerjet mbi 10,000 euro, subjektet politike obligohen që të ndjekin procedurën e shpalljes së hapur.
- 1.9. Subjektet politike obligohen t'i kenë të miratuara aktet nënligjore të brendshme për menaxhimin e financave dhe kontrollin e brendshëm financiar, brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

## **Neni 5**

### **Mirëmbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit mbështetës**

1. Subjekti politik ruan dokumentet mbështetëse në funksion të realizimit të aktiviteteve të cekura në nenin 4 të kësaj rregulloreje, që përfshinë, por nuk kufizohet në ftesat, agjendat, listat e pjesëmarrësve, kontratat, faturat e rregullta të shpenzimeve, kuponët fiskal, raportet e aktiviteteve, procesverbalet, fotografi, video materiale, etj.
2. Dokumentet si në paragrafin 1 të këtij neni, ruhen për një periudhë jo më gjatë se shtatë (7) vite.

## **Neni 6**

### **Raportimi vjetor financiar**

1. Subjektet politike obligohen që të dorëzojnë në Zyrë, për çdo vit, raportin vjetor financiar, më së largu deri më 1 mars të vitit vijuese në mënyrën e paraparë me këtë rregullore.
2. Zyra përmes e-mailit, do t'i njoftoj të gjithë përfaqësuesit financiar të subjekteve politike, së paku dy herë, para datës 1 mars të çdo viti.
3. Zyra para datës 10 shkurt të çdo viti, organizon takime me përfaqësuesit financiar të subjekteve politike, në lidhje me raportimin vjetor financiar.
4. Përveç të dhënave që duhet të përmbajë secili raport financiar ashtu siç është përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 15 të LFSP, raportet vjetore financiare duhet të përmbajnë edhe këto të dhëna plotësuese, si në vijim:

#### 4.1. Të dhënat e subjektit politik;

- 4.1.1. emrin e subjektit politik;
- 4.1.2. akronimin (nëse ka);
- 4.1.3. adresa e selisë qendrore të subjektit politik (rruga, numri, kodi postar dhe komuna);
- 4.1.4. periudha e raportimit (1 janar - 31 dhjetor);
- 4.1.5. numri i regjistrimit për qëllime të tatimit (NRF);
- 4.1.6. emri i bankës komerciale dhe numri i llogarisë bankare.

#### 4.2. Të dhënat e përfaqësuesi i autorizuar financiar;

- 4.2.1. emri dhe mbiemri;
- 4.2.2. numri personal i identifikimit;
- 4.2.3. adresa e vendbanimit (rruga dhe numri);
- 4.2.4. numri i telefonit kontaktues;
- 4.2.5. adresa elektronike (e-mail).

#### 4.3. Të dhënat për kryetarin e subjektit politik;

- 4.3.1. emri dhe mbiemri;
- 4.3.2. numri personal i identifikimit;
- 4.3.3. adresa e vendbanimit (emri i rrugës, numri dhe komuna);
- 4.3.4. komuna e vendbanimit;

- 4.3.5. numri i telefonit kontaktues;
  - 4.3.6. adresa elektronike (e-mail).
- 4.4. Përfaqësuesi i autorizuar financiar dhe kryetari i subjektit politik obligohen që ta nënshkruajë deklaratën se të dhënat e publikuara në formularin e raportimit vjetor janë të sakta, të plota dhe në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregullat e KQZ.
- 4.5. Pasqyra financiare vjetore duhet të përmbajë:
- 4.5.1. Pasqyrat e pozitës financiare, ku përfshihen gjithsejtë pasuritë, gjithsejtë ekuiteti dhe gjithsejtë detyrimet;
  - 4.5.2. pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve, e cila përfshinë: gjithsejtë të hyrat dhe gjithsejtë shpenzimet, gjatë periudhës raportuese;
  - 4.5.3. shënimet/ shpalosjet e raporteve financiare, duke përmbajtur shpalosjen e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe nivelin e pagesave.
- 4.6. Raportet vjetore financiare përpihohen sipas mostrës së përgatitur nga Zyra (shtojcë 1) dhe që përmban të dhënat si në vijim:
- 4.6.1. Të dhënat për të gjitha shpenzimet;
  - 4.6.2. kontributet në të holla;
  - 4.6.3. kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime;
  - 4.6.4. shënimet për tokat, objektet dhe pajisjet;
  - 4.6.5. shënimet tjera, që përfshijnë: llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e parasë, llogaritë e pagueshme dhe të tjera, detyrimet tjera afatshkurta;
  - 4.6.6. pasqyrën e cila tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave që i janë bërë atij personi gjatë kësaj periudhe tejkalon pesëmijë (5.000) euro, duke shënuar edhe qëllimin e pagesës.
- 4.7. Në shtojcën e raportit vjetor financiar, do të jetë forma e shkurtër e publikimit të raportit vjetor financiar, si pjesë e shtojcës 1, që përmban:
- 4.7.1. Pasqyra e gjendjes financiare, ku hyjnë pasuritë, ekuiteti dhe shpenzimet;
  - 4.7.2. pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve, ku hyjnë të hyrat dhe shpenzimet;
  - 4.7.3. shënimet – shpalosjet e pasqyrave.
5. Raporti vjetor financiar, i cili dorëzohet në Zyrë, duhet të jetë i nënshkruar nga kryetari i subjektit politik dhe përfaqësuesi financiar i subjektit politik.

6. Në mungesë të kryetarit të subjektit politik, raporti vjetor financiar mund të nënshkruhet nga anëtari i organit më të lartë ekzekutiv, përmes autorizimit të dhënë nga kryetari, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur.
  - 6.1. Nënshkrimi nga personi i autorizuar në emër të kryetarit të subjektit politik, vlen vetëm për dorëzim të raportit vjetor financiar dhe kryetari i subjektit politik mbetet përgjegjës për përmbajtjen e raportit vjetor financiar.
7. Në rast se subjekti politik shpërndahet në pajtim me statutin, së bashku me njoftimin për shpërndarje, e dorëzon edhe raportin vjetor financiar, që përfshin periudhën që përfundon me parashtrimin e kërkesës për shpërndarje. KQZ merr vendim për çregjistrim, vetëm nëse subjekti politik bashkë me njoftimin për shpërndarje, sjell edhe raportin financiar.
8. Në rast se subjekti politik nuk vazhdon regjistrimin deri me 31 mars, obligohet që brenda pesëmbëdhjetë (15) dite pas çregjistrimit, të dorëzoj në Zyrë, raportin vjetor financiar, që përfshinë periudhën e raportimit, deri me datën e çregjistrimit.
  - 8.1. Zyra e njofton subjektin politik se, në rast të mos dorëzimit të raportit vjetor financiar pas çregjistrimit dhe brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 8 të këtij neni, mund t'i shqiptoj gjobën në vlerën njëmijë (1,000) euro, kryetarit të subjektit politik dhe përfaqësuesit financiar të subjektit politik dhe se, në rast të mos pagesës së gjobës, Zyra inicon zhvillimin e procedurës përmbarese.
9. Pas çregjistrimit të partisë politike, siç është përcaktuar në paragrafët 7 dhe 8 të këtij neni, Zyra brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës, e njofton Bankën Qendrore të Kosovës, për bllokimin dhe deri në mbylljen e llogarisë bankare dhe Agjencinë Tatimore të Kosovës, për fshirjen e numrit fiskal.
  - 9.1. Njoftimi si në paragrafin 9 të këtij neni, do të përmbajë vendimin e KQZ për çregjistrimin e subjektit politik dhe informatat për subjektin politik, që përfshinë: emërtimin e subjektit politik, akronimin, numrin e regjistrimit si parti politike, të dhënat e kryetarit të subjektit politik dhe përfaqësuesit financiar të subjektit politik, që përfshinë emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe numrin personal të identifikimit.



## **Neni 7**

### **Kontributet për subjektet politike**

1. Kontributi për subjektet politike përfshijnë:
  - 1.1. Dhuratat;
  - 1.2. subvencionet;
  - 1.3. donacionet;
  - 1.4. cilido lloj i përfitimi që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo në natyrë, duke përfshirë pagesën e borxheve të subjektit politik dhe përfitimin përmes pronës, të huas, të huas së gjeneruar nga veprimtaritë ndërmarrëse, shërbimeve dhe të objekteve për shfrytëzim të subjektit politik.
2. Kontribut cilësohet edhe pranimi i një shërbimi ose vlere monetare ose materiale nga subjektet politike nën vlerën reale të tregut.
3. Ndalohen harxhimet e burimeve financiare, të referuara në paragrafët e mësipërm për qëllime personale.
4. Subjektet politike lejohen të marrin kontribute nga:
  - 4.1. Personat fizik, në vlerë prej, jo më shumë se dy mijë (2,000) euro për një (1) vit kalendarik;
  - 4.2. personat juridik në vlerë prej, jo më shumë se dhjetë mijë (10,000) euro për një (1) vit kalendarik.
5. Subjekti politik i cili pranon një kontribut, origjinën dhe prejardhjen e të cilit, kontribut dhënësi nuk mund ta dëshmojë, detyrohet brenda dy (2) jave, t'i njoftoj organet kompetente për vërtetimin e prejardhjes së këtij kontributi, si:
  - 5.1. Zyrën;
  - 5.2. Njësinë e Inteligjencës Financiare në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
6. Nëse nuk mund të dëshmohet prejardhja e kontributit, kjo vlerë transferohet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
7. Kontributet anonime janë të ndaluara.

## **Neni 8**

### **Kontributet në para të gatshme**

1. Çdo kontribut duhet të ketë informacionin e qartë në lidhje me kontribuuesin, duke përfshirë këto të dhëna:
  - 1.1. Emrin dhe mbiemrin e kontribuuesit (personit fizik);
  - 1.2. adresën e kontribuesit (personit fizik);
  - 1.3. numrin personal të identifikimit (personit fizik);
  - 1.4. data e kontributit (personit fizik);
  - 1.5. emrin e biznesit (personit juridik);
  - 1.6. emrin e pronarit të biznesit (personit fizik);
  - 1.7. emrin e pronarit përfitues të biznesit;
  - 1.8. adresën e selisë (personit juridik);
  - 1.9. numrin unik i biznesit (personit juridik);
  - 1.10. data e kontributit (personit juridik);
  - 1.11. deklaratën për prejardhjen e mjeteve.
  
2. Lista e kontributeve është pjesë përbërëse e Raportit vjetor financiar, si shtojcë II.

## **Neni 9**

### **Kontributet në natyrë**

1. Kontributet në natyrë, konsiderohen kontributet në mallra dhe shërbime, duke përfshirë pagesën e borxheve të subjektit politik, përfitimin përmes pronës, të huas, të huas së gjeneruar nga veprimtaritë ndërmarrëse, shërbimeve dhe të objekteve për shfrytëzim të subjektit politik.
  
2. Personi fizik ose personi juridik me dhënien e kontributit në natyrë, obligohet që të lëshoj deklaratë të dhënies së kontributit për subjektin politik – shtojca V, që tregon vlerën e tregut të mallit ose shërbimit dhe faturën.
  
3. Subjekti politik obligohet ta plotësoj formularin për pranimin e kontributit në natyrë me të dhënat, si në vijim:
  - 3.1. Përshkrimin e mallit ose shërbimit;
  - 3.2. emrin e kontribuesit, qoftë si person fizik ose juridik;
  - 3.3. adresën e kontribuuesit, duke përfshirë emrin e rrugës dhe komunën;
  - 3.4. numrin personal të identifikimit për personin fizik, ose numrin unik të regjistrimit për personin juridik;
  - 3.5. datën kur është dhënë kontributi dhe periudha kohore e shfrytëzimit;

- 3.6. vlerën totale në euro, sipas shumës së prezantuar në deklaratë.
4. Subjekti politik i regjistruar obligohet që ta plotësoj listën e kontributeve të pranuar në natyrë, si shtojcë III, në raportin vjetor financiar, të cilës i bashkëngjiten deklaratat e secili kontribut veç e veç.

## **Neni 10**

### **Ndalimi i ndihmave financiare për subjektet politike të regjistruara**

1. Ndalohen ndihmat financiare dhe materiale nga:
  - 1.1. Institucionet qeveritare dhe joqeveritare të huaja, si dhe personat fizikë dhe juridik të huaj;
  - 1.2. personat anonim fizik dhe juridik;
  - 1.3. dhuruesit (donatorët) anonim;
  - 1.4. institucionet dhe ndërmarrjet me kapital të fituar nga bixhozi, bastoret e ndryshme apo lojërat e fatit, si dhe nga;
  - 1.5. entet vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetërorë;
  - 1.6. ndërmarrjet private gjersa janë në marrëdhënie kontraktuale për ofrimin e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve me institucionet e Republikës së Kosovës dhe tre (3) vite pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale;
  - 1.7. organizatat jo qeveritare, organizatat humanitare, organizatat fetare dhe organizatat sindikale;
  - 1.8. personat fizik dhe juridik të cilët janë debitorë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës, kundër të cilëve është iniciuar procedurë përmbarimi;
  - 1.9. organizatat e të Rinjve, Fondacionet, Institutet apo trupa të ngjashme që janë të krijuara nga subjektet politike apo që kanë lidhje me subjektet politike ose që kryejnë aktivitete funksionale për subjektet politike.
2. Ndërmarrjet publike nuk mund t'i përkrahin financiarisht subjektet politike.
3. Ndalohet dhënia e donacioneve nga të cilat dhuruesi në mënyrë të qartë mund të përfitoj ndonjë avantazh ekonomik. Donacionet e personave fizik dhe juridik për subjekte politike duhet të bëhen në mënyrë transparente përmes llogarisë së vetme bankare dhe duhet të përfshihen në raportet financiare të subjekteve politike përfituese. Raporti financiar i subjekteve politike duhet të përmbajë emrin dhe numrin e regjistrimit për personat juridike apo emrin, mbiemrin dhe adresën për personat fizikë.
4. Kandidatët e subjekteve politike nuk mund të pranojnë asnjë donacion jashtë rregullave të përcaktuara përmes këtij ligji për financimin e subjekteve politike. Asnjë donacion nuk

mund të bëhet drejtpërdrejtë për kandidatin, por duhet të kalojë përmes subjektit politik, duke respektuar dispozitat e këtij ligji.

5. Subjekti politik, nënshkruan deklaratën nën betim - shtojca VII, përmes së cilës deklaron se, nuk ka pranuar ndihma financiare dhe materiale nga personat fizik dhe juridik, siç janë përcaktuar në këtë nen.

## **Neni 11**

### **Publikimi i raporteve vjetore financiare**

1. Subjektet politike përgatisin raportet vjetore financiare të përcaktuar nga KQZ, në formën elektronike dhe formën fizike.
2. Subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duhet t'i publikojnë raportet vjetore financiare të vitit paraprak, në ueb faqet e tyre funksionale, më së voni me datën 10 mars të çdo viti kalendarik.
3. Subjektet politike obligohen që raportet vjetore financiare të vitit paraprak, t'i mbajnë të publikuar në ueb faqet e tyre, së paku tre (3) vite.
4. Subjektet politike obligohen që raportet përfundimtare të auditimit për financimin vjetor të vitit paraprak, t'i publikojnë në ueb faqe, jo më vonë se dhjetë (10) ditë, nga dita e pranimit.
5. Zyra publikon Raportet vjetore financiare dhe raportet përfundimtare të auditimit në ueb faqen e KQZ.
  - 5.1. Raportet vjetore financiare dhe raportet përfundimtare të auditimit, mbahen të publikuara në ueb faqen e KQZ, së paku dhjetë (10) vite.
6. Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e raporteve vjetore financiare, Zyra lëshon komunikatë publike përmes së cilës njoftohet publiku për dorëzimin e raporteve financiare.

## **Neni 12**

### **Raportimi tremujor i shpenzimeve**

1. Subjektet politike, obligohen që për çdo tre muaj të dorëzojnë në Zyrë, raportin tre (3) mujor të shpenzimeve - shtojca IV, brenda afateve kohore, si në vijim:
  - 1.1. për shpenzimet e tre mujorit të parë TM 1 (janar-mars) raporti dorëzohet në Zyrë, më së voni me datën pesëmbëdhjetë (15) prill;
  - 1.2. për shpenzimet e tre mujorit të dytë TM 2 (prill-qershor) raporti dorëzohet në Zyrë, më së voni me datën pesëmbëdhjetë (15) korrik;
  - 1.3. për shpenzimet e tre mujorit të tretë TM 3 (korrik-shtator) raporti dorëzohet në Zyrë, më së voni me datën pesëmbëdhjetë (15) tetor;
  - 1.4. për shpenzimet e tre mujorit të katërt TM 4 (tetor-dhjetor) raporti dorëzohet në Zyrë, më së voni me datën pesëmbëdhjetë (15) janar, të vitit vijues.
2. Zyra, obligohet që përmes e-mailit, t'i njoftoj përfaqësuesit financiar të subjekteve, së paku pesë (5) ditë para se të filloj afati për dorëzimin e raporteve, të përcaktuara në paragrafin 1, të këtij neni.
3. Raportet tre mujore të shpenzimeve, duhet të kenë të bashkangjitura edhe listën e kontribuuesve që përfshijnë emrin dhe mbiemrin, në rast të personit fizik apo emërtimin e personit juridik si dhe llojin e shumës dhe datën e kontributit.
4. Raportet e shpenzimeve tre mujore, sipas paragrafit 3 të këtij neni, bëhen publike në ueb faqen e KQZ dhe në ueb faqet e subjekteve politike, jo më vonë se pesë (5) ditë pas përfundimit të afatit për dorëzim, për çdo tre mujorë.
5. Raportet tre mujore të publikuara nga subjektet politike dhe Zyra, duhet t'i kenë të mbuluar të dhënat personale, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që përfshinë: numrin personal të identifikimit, adresa (rruga dhe numri i rrugës) datën e lindjes (dita dhe muaji) numrin e telefonit dhe numrin e llogarisë bankare.
6. Raportet tre mujore të shpenzimeve dorëzohen në Zyrë, në formën fizike dhe elektronike.
7. Raportet tre (3) mujore të shpenzimeve, do të mbikëqyren nga Zyra.

## **Neni 13**

### **Kontrolli financiar**

1. Raportet vjetore financiare, auditohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
2. Auditimi i financave të subjekteve politike, kryhet nga auditorët ligjor.
3. Përmes konkursit të hapur publik, Zyra përzgjedh auditor të licencuar, qoftë si person fizik apo person juridik, të cilët do të auditojnë Raportet vjetore financiare dhe ndërmarrin veprime në emër të Zyrës.
4. Pas përzgjedhjes së listës së auditorëve, sipas paragrafit 3 të këtij neni, Zyra nga kjo listë do të caktojë me short auditorët të cilët do të jenë përgjegjës për auditimin e raporteve të subjekteve politike dhe tre (3) auditor në listën rezervë.
5. Zyra mund të iniciojë një verifikim të pajtueshmërisë për shkeljet e dëshmime nën betim të auditorëve, si shtojcë VI.
6. Subjekti politik obligohet që të bashkëpunoj ngushtë me auditorin e përzgjedhur dhe u ofron qasje të plotë dhe të pa penguar në shënimet financiare të subjektit, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.
7. Subjektet politike me kërkesë të auditorit i ofrojnë të gjitha dokumentet e kërkuara menjëherë dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.
8. Auditori mund të arrij në përfundimin se subjekti politik nuk ka bashkëpunuar plotësisht, në rast se:
  - 8.1. I kufizohet qasja në hapësirat e subjektit politik, ku mirëmbahen shënimet financiare, pas tri tentimeve të auditorit, pavarësisht nga arsyetimi i dhënë nga subjekti politik;
  - 8.2. mos përgjigja ndaj kërkesave apo mos ofrimi i dokumenteve të kërkuara, në një periudhë kohore më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune;
  - 8.3. rastet të tjera të mos bashkëpunimit, që pamundësojnë kryerjen e auditimit.
9. Mosbashkëpunimin sipas paragrafit 8 të këtij neni, auditori obligohet që ta dëshmoj përmes korrespondencës me shkrim që e ka pasur me përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik dhe ta informoj Zyrën për këtë.

10. Zyra heton rastet e mos bashkëpunimit dhe nëse rast se, konstaton konkluzionin e auditorit, i rekomandon KQZ që të nxjerrë vendim për ta privuar subjektin në fjalë nga përfitimi i fondit që ndahet nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin pasues.
11. Auditimi i raporteve vjetore financiare zhvillohet në periudhën kohore si në vijim:
  - 11.1. Auditimi i raporteve vjetore financiare fillon jo më vonë se data 30 mars i çdo viti;
  - 11.2. rezultatet preliminare të auditimit, përfshirë opinionin e auditimit përmes raportit preliminar, duhet të paraqiten në Zyrë, më së largu me datën 15 maj të çdo viti;
  - 11.3. nëse auditori konstaton se subjekti politik gjatë vitit auditues ka gjetje dhe parregullsi, atëherë auditori duhet t'i paraqes Zyrës edhe draft letër menaxhmentin, i cili përmban të gjeturat, ndikimin apo efektin dhe rekomandimet për përmirësime të procesit;
  - 11.4. Zyra, deri me datën 20 maj të çdo viti, ia prezanton dhe dërgon raportin preliminar të auditimit, personave të autorizuar të subjektit politik;
  - 11.5. subjekti politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i raportit preliminar të auditimit, mund ta dorëzoj raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin, përfshirë komentet lidhur me raportin preliminar të auditimit. Nëse subjekti politik i ka evidentuar këto gabime ose lëshime, të njëjtat i përcjell tek auditori. Mosrespektimi i këtij afati nënkupton pajtimin me të gjeturat e auditorit;
  - 11.6. auditori shqyrton rastet e kundërshtuara nga subjekti politik dhe nëse vlerëson se janë të bazuara, auditori korrigjon të gjeturat e evidentuara në raportin preliminar, të cilat reflektojnë në raportin përfundimtar të auditimit;
  - 11.7. nëse nuk ka kundërshtime nga ana e subjektit politik mbi të gjeturat e raportit preliminar të auditimit, auditori nxjerr raportin përfundimtar me opinionin e auditorit mbi financimin e subjektit politik;
  - 11.8. raportet përfundimtare të auditimit duhet të dorëzohen në Zyrë, më së largu me datën 15 qershor të çdo viti.

#### **Neni 14**

##### **Publikimi i raporteve përfundimtare të auditimit**

1. Zyra obligohet t'i publikojë në ueb faqen zyrtare të KQZ, raportet përfundimtare të auditimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi.
2. Jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas publikimit të raporteve përfundimtare të auditimit, Zyra mban konferencë për mediat dhe publikun, ku prezanton të gjeturat e raporteve.

3. Deri me datën 20 korrik të çdo viti, Zyra përgatit raport vjetor për KQZ, dhe i njëjti i pandryshuar si aneks i raportit nga KQZ i përcillet Kuvendit të Republikës së Kosovës, më së largu me datën 31 korrik të çdo viti.
4. Raporti përfshinë informatat për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi, duke përfshirë të gjeturat e dala nga procesi i auditimit dhe rekomandimet që Zyra nxjerr me qëllim të avancimit të mëtejshëm të mekanizmave për financimin e subjekteve politike, sidomos në aspektin e ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe të dhënat për shqiptimin e gjobave.
5. Zyra i dorëzon Raportet Përfundimtare të Auditimit në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, dhe/ ose agjencive tjera të zbatimit të ligjit, përfshirë Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Njësinë e Inteligjencës Financiare ose Administratën Tatimore të Kosovës, kur dyshimi për parregullsi bie nën kompetencën e njëres ose më shumë institucioneve të renditura më lartë.

## **Neni 15**

### **Dispozitat ndëshkuese**

1. Zyra shqipton gjoba në përputhje me dispozitat e LFSP, ndaj subjekteve politike dhe ndaj personave të saj përgjegjës, kandidatëve për kryetarë të komunave, kandidatëve tjerë të pavarur dhe çdo personi tjetër juridik ose fizik që e shkel LFSP dhe ligjet ose aktet tjera nënligjore.
2. Njësia përgjegjëse në Zyrë, harton rekomandimet për shqiptimin e gjobave, në bazë të të cilave, Drejtori i Zyrës merr vendimin për shqiptimin e gjobave.
3. Mjetet e mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Shqiptimi i gjobës ose i ndonjë sanksioni tjetër nga ana e Zyrës, nuk paragjykon aplikimin e ndonjë sanksioni penal ose ndonjë pasoje tjetër.
5. Nëse subjekti politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, i ka përdor fondet në kundërshtim me nenin 8 të LFSP dhe nenit 4 të kësaj rregulloreje, gjobitet në vlerën pesë mijë (5,000) euro.
6. Nëse natyra e shkeljes është e njëjtë, sikurse në paragrafin 5 të këtij neni, dhe përsëritet në dy raportet e një pas njëshme, subjektit politik, i shqiptohet gjoba në vlerën dhjetë mijë (10,000) euro.
7. Subjekti politik që ka dy (2) ose më shumë llogari bankare për të hyrat për financimin e rregullt të veprimtarisë së tyre në kundërshtim me nenin 4 të LFSP, me kushtin që gjatë vitit kalendarik ka realizuar transaksione bankare, gjobitet si në vijim:



- 7.1. subjektet politike të regjistruara që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, gjobiten në vlerën 4,000 euro;
- 7.2. subjektet politike që përfitojnë mjete nga fondi, gjobiten 8,000 euro.
8. Në rast se subjekti politik ka më shumë se një llogari bankare, Zyra përmes vendimit, e urdhëron mbylljen, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas ditës së pranimin të vendimit.
9. Nëse në llogarinë e dytë bankare, ose më shumë, ka transaksione të realizuara mbi vlerën pesëmijë (5,000) euro brenda vitit kalendarik, Zyra do të realizoj inspektimin e asaj llogarie bankare.
10. Subjekti politik, i cili nuk i ka mbajtur evidencat dhe nuk ka lëshuar dëftesë për pagesat e anëtarësimit dhe pagesat vullnetare, për kontributet jo financiare, pagesën e huave dhe kontributeve në natyrë, gjobiten si në vijim:
  - 10.1. subjektet politike të regjistruara që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, gjobiten 4,000 euro;
  - 10.2. subjektet politike që përfitojnë mjete nga fondi, gjobiten nga 4,000 euro deri në 10,000 euro.
11. Përveç gjobës së caktuar në paragrafin 10 të këtij neni, subjekti politik pezullohet në rast se, nuk ka mbajtur evidencat dhe nuk ka lëshuar dëftesë për pagesat e anëtarësimit dhe pagesat vullnetare, për kontributet jo financiare, pagesën e huave dhe kontributeve në natyrë, të cilat kalojnë vlerën mbi pesë mijë (5,000) euro.
  - 11.1. Subjekti politik obligohet që brenda pesëmbëdhjetë ditësh pas pranimin të vendimit të pezullimit, t'ia dorëzoj Zyrës, të gjitha dokumentet, siç përcaktohet në paragrafin 10 të këtij neni;
  - 11.2. Nëse subjekti politik, nuk i dorëzon evidencat dhe faturat sikurse në nën paragrafin 11.1, Zyra i rekomandon KQZ, çregjistrimin e subjektit politik.
12. Subjekti politik, i cili ka dorëzuar raportet vjetore financiare me të dhëna të pasakta dhe jo të plota, sipas nenit 15 të LFSP, gjobiten si në vijim:
  - 12.1. Subjektet politike të regjistruara, gjobiten 4,000 euro;
  - 12.2. subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, gjobiten nga 4,000 euro deri në 10,000 euro.

13. Subjekti politik, i cili nuk i ka dorëzuar pasqyrat financiare tremujore sipas afateve të përcaktuara në nenin 12 të kësaj rregulloreje, gjobitet në vlerën katërmijë (4,000) euro.
14. Subjekti politik i regjistruar, që ka dorëzuar raportin vjetor financiar, me vonesë, gjobitet në vlerën katër mijë (4,000) euro.
15. Subjekti politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, që ka dorëzuar raportin vjetor financiar, me vonesë, gjobitet në vlerën pesë mijë (5,000) euro.
16. Për qëllime të paragrafit 14 dhe 15 të këtij neni, vonesa nënkupton afatin prej 2 mars deri me datën 15 mars të çdo viti.
17. Subjekti politik, i cili nuk e dorëzon raportin vjetor financiar, deri me datën 15 mars, Zyra i rekomandon KQZ që të marrë vendim për pezullimin e subjektit politik, ku e obligon subjektin politik që brenda afatit shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ta dorëzojë në Zyrë, raportin vjetor financiar.
18. Nëse subjekti politik nuk ndërmerr veprimet për dorëzimin e raportit vjetor financiar, brenda afatit shtesë të dhënë me vendimin për pezullim, sipas rekomandimit të Zyrës, KQZ merr vendim për çregjistrimin e subjektit politik.
19. Evidencat, dëftesat e pagesave dhe dokumentet tjera, të cilat përbëjnë dëshmi se subjekti politik ka realizuar transaksione mbi vlerën 4,000 euro gjatë vitit kalendarik, obligohet që t'i dorëzojë në Zyrë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të vendimit për çregjistrim.
20. Subjekti politik, i cili ka pranuar kontribut në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, obligohet që të ndërmarrë veprimet më poshtë:
  - 20.1. subjekti politik, i cili ka pranuar kontribute (donacione) në shumën mbi 2,000 euro prej të njëjtit person fizik brenda një viti kalendarik, obligohet që pjesën e shumës mbi 2,000 euro, ta kthejë tek kontribut dhënësi, brenda dy (2) javësh, pas ditës së pranimit dhe ta njoftoj Zyrën;
  - 20.2. subjekti politik, i cili ka pranuar kontribute (donacione) në vlerën mbi 10,000 euro, prej të njëjtit personit juridik, brenda një viti kalendarik, obligohet që pjesën e shumës mbi 10,000 euro, ta kthejë tek kontribut dhënësi, brenda dy (2) javësh, pas ditës së pranimit dhe ta njoftoj Zyrën.
21. Në rast të tejkalimit të afatit të paraparë në nën paragrafin 20.1 të paragrafit 20 të këtij neni, për donacionin e pranuar nga personi fizik, Zyra shqipton gjobën ndaj subjektit politik në dyfishin e vlerës së tejkaluar, por jo më pak se katërmijë (4,000) euro.

22. Në rast të tejkalimit të afatit të paraparë në nën paragrafin 20.2 të paragrafit 20 të këtij neni, për donacionin e pranuar nga personi juridik, Zyra shqipton gjobën ndaj subjektit politik në dyfishin e vlerës së tejkaluar, por jo më pak se katërmijë (4,000) euro.
23. Subjekti politik, i cili ka pranuar kontribut nga personat ose institucionet e parapara në nenin 10 të kësaj rregulloreje, obligohet që mjetet t'i kthejë te kontribut dhënësi, brenda dy (2) javësh, pas ditës së pranimin dhe ta njoftoj Zyrën.
- 23.1. Në rast se ka dëshmi, se mjetet financiare janë pranuar nga organizatat terroriste të shpallura nga institucione ndërkombëtare dhe organizata që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, integritetin dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës, Zyra ndërmerr veprime dhe njofton institucionet kompetente për ngrirjen e fondeve dhe transferimin e tyre në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
24. Nëse subjekti politik, nuk i kthen mjetet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 23 të këtij neni, Zyra në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, ndërmerr veprime për tërheqjen dhe transferimin e mjeteve në buxhetin e Republikës së Kosovës.
25. Pavarësisht veprimeve sipas paragrafit 24 të këtij neni, subjekti politik gjohet me dyfishin e vlerës së pranuar, por jo më pak se 4,000 euro dhe jo më shumë se 40,000 euro.
- 25.1. Personave përgjegjës të subjektit politik, kryetarit dhe përfaqësuesit financiar, i shqiptohet gjoba 1,000 euro për rastet si në vijim:
- 25.1.1. për shkak të dorëzimit me vonesë të raporteve tremujore të pasqyrave financiare;
- 25.1.2. për shkak të dorëzimit me vonesë të raportit vjetor financiar;
- 25.1.3. për shkak se nuk i kanë siguruar qasje në zyra dhe në libra (evidenca) për auditorët edhe pas paralajmërimit nga ana e Zyrës;
- 25.1.4. për shkak se, fondet janë përdorur në kundërshtim me nenin 4 të kësaj rregulloreje;
- 25.1.5. për shkak se subjekti politik që përfaqësojnë, ka dy ose më shumë llogari bankare për të hyrat për financimin e rregullt të veprimtarisë së subjektit politik;
- 25.1.6. për shkak se, subjekti politik nuk i ka mbajtur evidencat dhe nuk ka lëshuar dëftesë për pagesat e anëtarësimit dhe pagesat vullnetare, kontributet jo financiare, pagesën e huave;
- 25.1.7. për shkak se, subjekti politik që përfaqësojnë, ka pranuar kontributeve në kundërshtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

26. Gjobat e shqiptuara sipas paragrafit 25 të këtij neni, paguhen individualisht, nga përfaqësuesit e autorizuar të subjektit politik, varësisht se kujt iu është shqiptuar gjoba dhe jo nga mjetet financiare të subjektit politik.
27. Personat fizik dënohen me gjobë në vlerën 1,000 euro, në këto raste:
- 27.1. për arsye të mos lëshimit të dëshmisë për çdo kontribut të bërë subjektit politik, me anë të mallrave dhe shërbimeve;
  - 27.2. nëse malli ose shërbimi nuk korrespondon me vlerën e tregut të mallit ose shërbimit, siç përcaktohet në LFSP;
  - 27.3. për dhënien e kontributit për subjektin politik, që është në kundërshtim me ndalimin e përcaktuar në nenin 11 të LFSP.
28. Personat juridik dënohen me gjobë dyfishin e vlerës së dhënë apo të tejkualuar, në vlerën jo më pak se pesë mijë (5,000) euro dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë mijë (15,000) euro, në këto raste:
- 28.1. për arsye të mos lëshimit të dëshmisë për çdo kontribut të bërë me anë të mallrave dhe shërbimeve;
  - 28.2. nëse malli ose shërbimi nuk korrespondon me vlerën e tregut të mallit ose shërbimit, siç përcaktohet në LFSP;
  - 28.3. për dhënien e kontributit për subjektin politik, që është në kundërshtim me ndalimin e përcaktuar në nenin 11 të LFSP.
29. Në rast se, subjekti politik nuk paguan gjobën e shqiptuar, i ndalohet certifikimi në zgjedhje.

## **Neni 16**

### **Ekzekutimi i gjobave**

1. Zyra, i shqipton gjobat sipas shkeljeve të përcaktuara në nenin 15 të kësaj rregulloreje.
2. Vendimet për shqiptimin e gjobave, janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.
3. Subjekti politik, personi përgjegjës, kandidatët për kryetarë të komunave, kandidatët e tjerë të pavarur dhe çdo person tjetër fizik ose juridik kundër të cilit është shqiptuar gjobë mund të iniciojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit, siç përcaktohet me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Nëse subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, pas pranimit të vendimit të Zyrës, në këtë

rast, subjektit politik i ndalohet transferimi i mjeteve nga fondi në shumën e gjobës së shqiptuar.

5. Nëse shuma e gjobës së shqiptuar, është më e lartë se mjetet që i ndahen për çdo tre mujor, ndalimi i mjeteve do të vazhdoj, deri në arritjen e shumës së gjobës.
6. Nëse subjekti politik i regjistruar, nuk paguan gjobën, në këtë rast, subjekti politik nuk do të certifikohet në zgjedhje, deri në pagesën e gjobës së shqiptuar.
7. Nëse gjobat nuk paguhen brenda afatit tridhjetë (30) ditorë, Zyra do të iniciojë procedurën përbarimore, siç përcaktohet me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, për:
  - 7.1. Subjektin politik të regjistruar, që nuk është i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës;
  - 7.2. personat e autorizuar të subjekteve politike të regjistruara dhe subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës;
  - 7.3. personat fizik dhe juridik.

## **Neni 17**

### **Mbikëqyrja financiare**

1. Zyra ka mandat të mbikëqyr në çdo rast, nëse konsiderohet se një subjekt politik ka shkelur dispozitat ligjore të LFSP dhe aktet nënligjore.
2. Çdo person fizik ose juridik dhe institucion publik, mund të raportoj në Zyrë, parregullsitë financiare të subjekteve politike.
3. Mbikëqyrja inicohet mbi bazën e ankesave të parashtruara nga çdo person fizik ose juridik, edhe në formën anonime, informacionet e dhëna nga institucionet publike ose me vendim të Drejtorit të Zyrës.
  - 3.1. Në rast se, nga ankesa e parashtruar konstatohet se, pretendimet nuk qëndrojnë, Zyra hedh poshtë kërkesën dhe e njofton parashtruesin e ankesës;
  - 3.2. në rast se, konstatohet se ka dëshmi të konsiderueshme të ndonjë parregullsie, Drejtori i Zyrës nxjerr vendim për verifikim të përshtatshmërisë.
4. Pas nxjerrjes së vendimit për verifikimin e pajtueshmërisë, Drejtori i Zyrës ia cakton lëndën sipas shortit, zyrtarit të Njesisë së Kontrollit Financiar të Subjekteve në Zyrë, që do të vërtetoj faktet dhe do të mbledh dëshmi për parregullsinë e pretenduar.

5. Zyra mund të kërkoj çdo informacion të nevojshëm lidhur me verifikimin e pajtueshmërisë nga institucionet private dhe publike.
6. Subjekti politik mund të ofroj çdo informacion dhe dëshmi që kundërshtojnë parregullsinë e pretenduar.
7. Procedura e verifikimit të pajtueshmërisë, mund të zgjasë jo më shumë se tre (3) muaj, pas paraqitjes së parregullsisë.
8. Trajtimi i lëndës mund të zgjasë më së largu deri në gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi edhe për dy (2) muaj shtesë, sipas arsytimit të dhënë.
9. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë, Drejtori të Zyrës i dorëzohet raporti përfundimtar nga zyrtari që ka realizuar verifikimin e pajtueshmërisë, që përmban të gjitha faktet dhe dëshmitë e grumbulluara, me një rekomandim përfundimtar, në bazë të së cilit:
  - 9.1. Nxirret vendimi nëse subjekti politik ka shkelur dispozitat e LFSP, dhe në bazë të shkeljes, i shqiptohet gjoba, siç është përcaktuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje;
10. Nëse konstatohet se subjekti politik është në kundërshtim me dispozitat ligjore, Zyra përmes vendimit, kërkon nga subjekti politik eliminimin ose korrigjimin vullnetar të gjetjeve dhe mangësive, nëse ato mund të eliminohen ose korrigjohen.
11. Nëse subjekti politik nuk vepron brenda afatit të përcaktuar sipas vendimit të Zyrës, atëherë subjektit politik i vendosen sanksione nga Zyra, të përcaktuara në nenin 15 të kësaj rregulloreje.
12. Pavarësisht procesit të auditimit dhe pavarësisht gjobave të shqiptuara, siç janë përcaktuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje, nëse dyshohet se është kryer një vepër penale, është kryer një shkelje tatimore, ka pasur shkelje të konfliktit të interesit, Zyra menjëherë njofton autoritetin kompetent, si, Zyrën e Prokurorit të Shtetit, Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiar dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

## **Neni 18**

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulla nr. 04/2015 mbi financimin e subjekteve politike dhe sanksionet.
2. Subjektet politike të regjistruara, obligohen që brenda tridhjetë (30) ditësh pas miratimit të kësaj rregulloreje të hapin llogarinë bankare dhe të regjistrohen në institucionin përkatës për tu pajisur me numrin fiskal.
3. Në rast se subjekti politik, nuk i ndërmerr veprimet sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të aplikohen masat e pezullimit dhe çregjistrimit, siç janë përcaktuar në nenin 2 të kësaj rregulloreje.
4. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:
  - 4.1. Shtojca I - Formulari i Raportit vjetor financiar;
  - 4.2. shtojca II - Lista e kontribuuesve për dhënien e mjeteve financiare në të holla;
  - 4.3. shtojca III - Lista e kontribuuesve në natyrë, mall dhe shërbime;
  - 4.4. shtojca IV - Raporti tre mujor financiar;
  - 4.5. shtojca V - Deklarata e dhënies së kontributit në natyrë;
  - 4.6. shtojca VI - Verifikimi i pajtueshmërisë për shkeljet e dëshmimeve nën betim të auditorëve;
  - 4.7. shtojca VII - Deklarata nën betim.
5. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Zyra nxjerrë procedurën për mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike.
6. Për zbatimin e LFSP dhe të kësaj rregulloreje, Zyra kujdeset që t'i rekomandoj KQZ lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet tjera relevante.
7. Zyra, jo më vonë se gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, zhvillon platformën elektronike që mundëson evidentimin dhe raportimin e shpenzimeve në mënyrë të sistematizuar nga secili subjekt politik.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**